



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 maj 2018
Nr. ref.: RK 1229/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI72/17

Parashtrues

Ajkune Shala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 15/2017, të 8 marsit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ajkune Shala nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Ramiz Suka, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 15/2017] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 marsit 2017, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtrueses së kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2326/2013, të 31 tetorit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 qershor 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 22 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Cukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 26 korrik 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 22 shkurt 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 17 korrik 2001, gjatë kryerjes së detyrave të punës në objektin e punëdhënësit të tij (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës pësoi lëndime trupore, nga të cilat më vonë ndërroi jetë.
10. Më 16 nëntor 2005, Prokurori Publik Komunal (në tekstin e mëtejme: PPK), ngriti në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë aktakuzën PP. nr. 1799-1/2001 kundër punëdhënësit, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm.

11. Më 11 nëntor 2008, Gjykata e atëhershme Komunale (Aktgjykimi P. nr. 2909/03) hodhi poshtë aktakuzën dhe ndërpreu procedurën penale kundër punëdhënësit të saj *“për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale”*.
12. Më 6 nëntor 2007, parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Gjykatën Komunale padi civile duke kërkuar që ta obligojë punëdhënësin që *“t’i paguajë paditëses kompensimin material dhe jomaterial për prindin e tyre, përkatësisht bashkëshortit”*.
13. Më 19 shkurt 2013, tani Gjykata Themelore (Aktgjykimi C. nr. 2418/07), e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses, duke arsyetuar se në pajtim me nenin 358 (2) të LMD-së *“ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjellë edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit”*.
14. Parashtruesja parashtrroi në Gjykatën e Apelit ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
15. Më 31 tetor 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 2326/13), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konsideruar se *“gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve për shkak të vjetërsimit të kërkesës për kompensim dëmi”*.
16. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Gjykatën Supreme kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit *“për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
17. Më 8 mars 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 15/2017) refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës, duke arsyetuar që *“... gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, [...] ... sepse, sipas dispozitës së nenit 376 të LMD, afati i vjetërsimit është 3 (tri) vjet, përkatësisht afati pesëvjeçar nga dita e shkaktimit të dëmit në çdo rast”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Ligji i punës në fuqi në kohën e vdekjes së bashkëshortit të saj, e obligon punëdhënësin që t’ia kompensojë dëmin i cili i është shkaktuar në punë edhe në rastet kur punëtorja nuk është fajtoare për aksidentin.
19. Më tej, parashtruesja e kërkesës konsideron se gjykatat me refuzimin e kërkesëpadisë së saj për kompensim ia kanë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
20. Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesën e saj nuk ka cekur shprehimisht se çfarë zgjidhje kërkon nga Gjykata.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se ka shteruar mjetet juridike dhe ka parashtruar kërkesën në afatin e paraparë.

25. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh paragrafët (1) (d) dhe (2) (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

27. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse gjykatat e rregullta e refuzuan

- kërkesëpadinë e saj për kompensim për vdekjen e burrit të saj, që kishte ndodhur në punë.
28. Në këtë drejtim, Gjykata paraprakisht vlerëson se gjykatat e rregullta merreshin ekskluzivisht vetëm me çështje procedurale lidhur me afatet e parashkrimit të padisë për kompensim.
 29. Në të vërtetë, Gjykata vëren se kërkesëpadia, ankesat dhe revizioni i parashtrueses së kërkesës ishin refuzuar, sepse, siç thuhet nga Gjykata Supreme *“gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar me të drejtë se bashkëshorti i [parashtrueses së kërkesës], (...) ka vdekur në punë me dt. 17.07.2001, ndërsa paditësit kanë parashtruar padi në gjykatë më 06.11.2007, çka do të thotë se më shumë se 6-të vite, gjë që e bënë të vjetërsuar kërkesën e tyre për këtë lloj kompensimi në kuptim të nenit 376 të LMD me të cilin afat është paraparë afati 3 vjeçar i vjetërsimit përkatësisht afati 5 vjeçar nga dita e shkakimit të dëmit në çdo rast”*.
 30. Në të vërtetë, Gjykata rikujton që Gjykata Themelore konstatoi se kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës nuk mund të pranohej sepse neni 358 (2) i LMD-së parasheh se *“ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjellë edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit”*.
 31. Gjykata gjithashtu rikujton se Gjykata e Apelit vlerësoi se bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës *“vdiq më 17 korrik 2001, ndërsa paditësit kanë parashtruar padi në Gjykatë më 06.11.2007, çka do të thotë se më shumë se 6-të vite”*. Gjykata e Apelit e vlerësoi që *“që e bënë të vjetërsuar kërkesën e tyre për këtë lloj kompensimi në kuptim të nenit 376 të LMD me të cilin afat është paraparë afati 3 vjeçar i vjetërsimit”*.
 32. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta shpjegojnë plotësisht se përse kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensim për vdekjen e bashkëshortit të saj nuk mund të pranohej.
 33. Gjykata rikujton që në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
 34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, ngjashëm me GJEDNJ-në, nuk është funksioni i Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve apo ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta (çështje e ligjshmërisë) përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (çështje e kushtetutshmërisë) (shih: rasti i GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, 21 janar 1999, paragrafi 28)“.
 35. Prandaj, Gjykata thekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj ajo nuk mund të veprojë si *“gjykatë e shkallës së katërt”* (Shih: rasti i GJEDNJ-së, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim i 5 prillit 2012).

36. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta, duke vepruar nën juridiksionin e tyre, e kanë zbatuar ligjin në mënyrë të arsyetuar dhe të drejtë.
37. Përveç kësaj, është obligim i parashtrueses së kërkesës të paraqesë prova dhe të ndërtojë argumente që tregojnë shkelje kushtetuese të të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih rastin i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylaj*, Aktvendim i 5 dhjetorit 2013).
38. Megjithatë, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e prezantuar nga parashtruesja e kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se ato kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë, përkatësisht se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtrueses së kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, gjë që do të kishte rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës ose të nenit 6 (1) të KEDNJ-së.
39. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës kishte përfituar nga procedurat të bazuara në parimin e kontradiktoritetit, ku ajo ishte në gjendje të paraqesë argumentet që ajo i konsideronte të rëndësishme për rastin e saj. Arsyet ligjore për vendimet e gjykatave të rregullta me të cilat ishte refuzuar si e papranueshme kërkesëpadia e saj ishin parashtruar gjerësisht.
40. Prandaj, Gjykata konsideron se, marrë në tërësi, procedurat dhe vendimet e gjykatave të rregullta ishin të justifikuara dhe të drejta për qëllimet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të Konventës.
41. Prandaj, kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (d) dhe (2) (b), dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 shkurt 2018, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi